

VENDIM
Nr. 660, datë 23.10.2024

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI I QENDRËS SË FSHATIT LIBOFSHË, NJËSIA
ADMINISTRATIVE LIBOFSHË, BASHKIA FIER”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i qendrës së fshatit Libofshë, Njësia Administrative Libofshë, Bashkia Fier”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “njësi” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 294 661 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 294 661 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Fier.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Fier.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Fier.

8. Bashkia Fier kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Fier.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë që shpronësohen, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Fier.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë që shpronësohen, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Fier.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Fier, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN
NGA SHPRONËSIMI PËR INTERES PUBLIK PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “RIKUALIFIKIMI I
QENDRËS SË FSHATIT LIBOFSHË, NJËSIA ADMINISTRATIVE LIBOFSHË, BASHKIA FIER”**

Nr. RENDOR	PONARI	Të DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)				VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM				SHËNIME/KUFIZIME MBI PRONËSINË ETJ.
	EMËR ATËSIA MBIEMËR	ZONA KADASTRALE	Nr. PASURIE	LLOJI I PASURISË	SIP. E OBJEKTIT TË SHËRBIMIT (M ²)	ÇMIMI OBJEKTIT TË BANIMIT (L/M ²)	VLERA E OBJEKTIT TË SHËRBIMIT SIPAS SITUACIONIT (LEKË)	VLERA E OBJEKTIT TË BANIMIT (LEKË)	VLERA TOTALE E TRUALLIT, OBJEKTIT TË BANIMIT DHE SHËRBIMIT (LEKË)	
1	URANI KOVISHYTE	2443	16/24 - N3	NJËSI	33.50		425,477		425,477	KONFIRMUAR NGA ASHK, ME CERTIFIKATË PRONËSIE DATË 16.5.2011
2	QIBARETE HASIM HASANI	2443	16/24 - N4	NJËSI	33.50		194,348		194,348	KONFIRMUAR NGA ASHK, ME CERTIFIKATË PRONËSIE DATË 6.4.2012
3	KATERINA NDINI BABULI GRIGOR THOMA BABULI	2443	16/24 - N5	NJËSI	33.50		561,824		561,824	KONFIRMUAR NGA ASHK, ME CERTIFIKATË PRONËSIE DATË 10.6.2014
4	QIBARETE HASIM HASANI	2443	16/27-ND	NDËRTESE	32.92		113,012		113,012	KONFIRMUAR NGA ASHK, ME CERTIFIKATË PRONËSIE DATË 9.4.2012
VLERA TOTALE									1,294,661	